



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3731/ 9 prot.,

Datë 20.01.2026

V E N D I M
Nr. 106/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur, Mallra; Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te Percaktuara”, me Nr.REF-65176-10-15-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Shoqërisë”, me fond limit 11,510,570 (njembedhjetë milion e pesëqind e dhjetë mijë e pesëqind e shtatedhjetë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 27.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me Nipt J62903470T dhe adresë: L. KRYENGRITJA E FIERIT, Fier

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A
Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu”. Sarandë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “NIKA TRADING SA” SHPK me Nipt. M13817805J dhe adresë: Lagjja nr.4, Rruga Idriz Alidhima, godina nr.5, kati parë, Sarandë

Operatori ekonomik “GENERAL TRADING” SHPK me Nipt. M21501011F dhe adresë: Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga Ben Mjalti, Njësia Administrative Pezë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Ankimesi “VASAA” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedure e Hapur, Mallra; Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te Percaktuara”, me Nr.REF-65176-10-15-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Shoqërisë”, me fond limit 11,510,570 (njembedhjetë milion e peseqind e dhjetë mijë e peseqind e shtatedhjetë) lekë pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar më datë 27.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Në datën 27.11.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 11.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “NIKA TRADING SA “ SHPK	9.092.000 lekë	kualifikuar
2. “GENERAL TRADING” SHPK	9.545.120 lekë	kualifikuar
3. “VASAA” SHPK	9.874.720 lekë	kualifikuar
4. “Erkla” SHPK	10.412.780 lekë	s’kualifikuar
5. “EDICO GROUP” SHPK	10.563.812,35 lekë	kualifikuar
6. “INSTANT.AL” SHPK	11.100.500 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 22.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “*Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak*” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6225 datë 29.12.2025 dhe me Nr. 3731/2025 Prot., datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

“.....1. Kualifikimi i operatorit “Nika Trading sa” nga KVO është bërë në shkelje të nenit

77pika 4,5 e ligjit të LPP-së 162, datë 23.12.2020, pasi Operatori Nika Trading sa, nuk plotëson kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST-së, pika 2.3.1, Kapaciteti Teknik: Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të mëparshme, për furnizime të ngjashme me objektin e kontratës. Për të provuar këtë, duhet të paraqesë dëshmi për realizimin e furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A, tek kjo procedurë prokurimi ka proceduar ndërmjet artikujve të shumtë edhe për dias pajisje të vecanta për lëshimin e elektropompe sipas tabelës së mëposhtme:

1. PAJISJE TE VECANTA PER LESHIMIN E ELEKTROPOMPAVE

1	Panel komandimi me Soft-Starter 22 kW, per elektropompe zhytese 15 kW
2	Panel komandimi me Soft-Starter 30 kW, per elektropompe zhytese 22 kW
3	Panel komandimi me Soft-Starter 45 kW, per elektropompe zhytese 37 kW
4	Soft-Starter 220 kW, per elektropompe zhytese 200 kW
5	Inverter 400V, me fuqi 200 kW
6	Inverter 400V, me fuqi 50 kW

Operatori ekonomik “Nika Trading sa”, nuk ka realizuar në aktivitetin e vet ekonomik kontratë shitje të mëparshme për këto artikuj, të cilët zënë një vlerë të konsiderueshme, prej 23 % të vlerës së procedurës.

Këto artikuj janë shumë të rëndësishëm, madje kritike për funksionimin e një shoqërie Ujësjetllës Kanalizime

2. PAJISJE TM + MATERIALE PER KABINAT ELEKTRIKE

1	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 630 kVA
2	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 250 kVA
3	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 100 kVA
4	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 50 kVA
5	Cele linje 24 kV, 630 A
6	Cele transformatori 24 kV, 630 A
7	Sigurese 20 kV, 20A
8	Sigurese 20 kV, 25A

9	Bazament siguresse 20 kV
10	Siguresse 10 kV, 10A
11	Siguresse 10 kV, 15A
12	Siguresse 10 kV, 20A
13	Siguresse 10 kV, 25A
14	Bazament siguresse 10 kV
15	Thike TM 10 kV, 400 A
16	Shkarkues 10 kV
17	Shkarkues 20 kV
18	Doreza Dielektrike
19	Kepuce Dielektrike
20	Tapeta dielektrik 80x40 cm
21	Tabela te sigurimit teknik
22	Indikator TM 10 kV
23	Indikator TM 20 kV
24	Shtange TM 20 kV
j	
25	Koka kablli TM 10 kV
26	Koka kablli TM 20 kV

Operatori ekonomik “Nika Trading sa”, nuk ka realizuar në aktivitetin e vet ekonomik kontratë shitje të mëparshme për këto artikuj, të cilët zënë një vlerë të konsiderueshme, prej 50 % të vlerës së procedurës.

Këto 26 artikuj përbëjnë bërthamën teknike të rrjetit të mesëm/ulët të tensionit dhe janë thelbësorë për çdo Shoqëri Ujësjetës- Kanalizime....

2. Kualifikimi i operatorit “General Trading” shpk nga KVO është bërë në shkellje të nenit 77pika 4,5 e ligjit të LPP-së 162, datë 23.12.2020, pasi Operatori Nika Trading sa, nuk plotëson kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST-së, pika 2.3.1, Kapaciteti Teknik:

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të mëparshme, për furnizime të ngjashme me objektin e kontratës. Për të provuar këtë, duhet të paraqesë dëshmi për realizimin e furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Siç argumentuam edhe operatori General Trading shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.3.1, Kapaciteti Teknik pasi për Grup artikujt e mëposhtëm nuk disponon dëshmi për furnizime të tyre:, tek kjo procedurë prokurimi ka proceduar ndërmjet artikujve të shumtë edhe për dias pajisje të vecanta për lëshimin e elektropompave sipas tabelës së mëposhtme:

1	Panel komandimi me Soft-Starter 22 kW, per elektropompe zhytese 15 kW
2	Panel komandimi me Soft-Starter 30 kW, per elektropompe zhytese 22 kW
3	Panel komandimi me Soft-Starter 45 kW, per elektropompe zhytese 37 kW
4	Soft-Starter 220 kW, per elektropompe zhytese 200 kW
5	Inverter 400V, me fuqi 200 kW
6	Inverter 400V, me fuqi 50 kW

1	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 630 kVA
2	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 250 kVA
3	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 100 kVA
4	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 50 kVA
5	Cele linje 24 kV, 630 A
6	Cele transformatori 24 kV, 630 A
7	Sigurese 20 kV, 20A
8	Sigurese 20 kV, 25A
9	Bazament sigurese 20 kV
10	Sigurese 10 kV, 10A
11	Sigurese 10 kV, 15A
12	Sigurese 10 kV, 20A
13	Sigurese 10 kV, 25A
14	Bazament sigurese 10 kV
15	Thike TM 10 kV, 400 A
16	Shkarkues 10 kV
17	Shkarkues 20 kV
18	Doreza Dielektrike
19	Kepuce Dielektrike
20	Tapeta dielektrik 80x40 cm
21	Tabela te sigurimit teknik
22	Indikator TM 10 kV
23	Indikator TM 20 kV
24	Shtange TM 20 kV
j	
25	Koka kablli TM 10 kV

Kërkojmë nga KPP s'kualifikimin e operatorëve ekonomikë “nika Trading sa” “General trading” shpk si të kualifikuar në shkelje të ligjit 162 të LPP-së..”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3731/1 prot., datë 30.12.2025, korrigjuar me vendimin e KPP nr.27/2026, datë 07.01.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “VASAA” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me objekt “Vendim për shqyrtim ankesë”, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3731/6 prot., datë 19.01.2026, të ardhur nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave është depozituar nga autoriteti kontraktor akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës së operatorit ekonomik “VASAA” SHPK

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK me pretendimin për mospërmbushje nga ana e këtyre të fundit të kriterit **2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të mëparshme, për furnizime të ngjashme me objektin e kontratës. Për të provuar këtë, duhet të paraqesë dëshmi për realizimin e furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës pasi

nuk pasi nuk kanë kontrata të ngjashme për grupet e artikujve pajisje te vecanta per leshimin e elektropompave dhe pajisje tm + materiale per kabinat elektrike ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1 në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të mëparshme, për furnizime të ngjashme me objektin e kontratës. Për të provuar këtë, duhet të paraqesë dëshmi per realizimin e furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

III.2.2. Në shtojcën 7, “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar sipas preventivit bashkëlidhur këtyre DST artikujt në sasi si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

PREVENTIV

Objekti: "Blerje materiale elektrike për nevojat e Shoqërisë".

Autoriteti Kontraktor: "Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a"

Nr.	An	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
		MATERIALE + AKSESORE PER PANELET E POMPAVE				
1	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 11 kW	cope	2		
2	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 15 kW	cope	2		
3	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 18 kW	cope	2		

4	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 22 kW	cope	2		
5	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 30 kW	cope	2		
6	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 37 kW	cope	2		
7	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 45 kW	cope	2		
8	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 55 kW	cope	2		
9	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 60 kW	cope	2		
10	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 132 kW	cope	1		
11	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 220 kW	cope	1		
12	k.ngj	Leshues magnetik (kontaktor) 380-400 V 265 LC1F	cope	1		
13	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 1000 A	cope	1		
14	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 630 A	cope	1		
15	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 400 A	cope	1		
16	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 250 A	cope	1		
17	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 160 A	cope	1		
18	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 100 A	cope	3		
19	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 80 A	cope	3		
20	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 63 A	cope	3		
21	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 40 A	cope	5		
22	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 32 A	cope	5		
23	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 25 A	cope	5		
24	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 20 A	cope	5		
25	k.ngj	Automat magneto-termik 3P 16 A	cope	5		
26	k.ngj	Automat magneto-termik 1P 25 A	cope	5		
27	k.ngj	Automat magneto-termik 1P 16 A	cope	5		
28	k.ngj	Automat magneto-termik 1P 10 A	cope	5		
29	k.ngj	Automat magneto-termik 1P 6 A	cope	5		
30	k.ngj	Llampa sinjalizimi 1P	cope	5		
31	k.ngj	Rele kohe 24h, sauter	cope	5		
32	k.ngj	Rele kohe 220V 0-60 sek	cope	5		
33	k.ngj	Rele prezence tensioni (asimetrie)	cope	5		
34	k.ngj	Rele leshim elektromotri Y/ Δ	cope	5		
35	k.ngj	Rele niveli uji	cope	5		
36	k.ngj	Bazament Releje (8 kunja)	cope	5		
37	k.ngj	Rele termike 10 A	cope	5		
38	k.ngj	Rele termike 20 A	cope	5		
39	k.ngj	Rele termike 30 A	cope	5		
40	k.ngj	Rele termike 40 A	cope	5		
41	k.ngj	Rele termike 50 A	cope	5		
42	k.ngj	Rele termike 60 A	cope	2		
43	k.ngj	Rele termike 70 A	cope	2		

44	k.ngj	Rele termike 80 A	cope	2		
45	k.ngj	Rele termike 90 A	cope	2		
46	k.ngj	Rele termike 100 A	cope	2		
47	k.ngj	Rele termike 200 A	cope	2		
48	k.ngj	Rele magneto-termike 15 A (salvamoto)	cope	2		
49	k.ngj	Rele magneto-termike 25 A (salvamoto)	cope	2		
50	k.ngj	Rele magneto-termike 35 A (salvamoto)	cope	2		
51	k.ngj	Rele magneto-termike 45 A (salvamoto)	cope	2		
52	k.ngj	Rele magneto-termike 65 A (salvamoto)	cope	2		
53	k.ngj	Rele magneto-termike 85 A (salvamoto)	cope	2		
54	k.ngj	Buton komandimi Start-Stop	cope	5		
55	k.ngj	Llampa sinjalizimi paneli LED $\Phi=22$ mm	cope	20		
56	k.ngj	Galixhant elektrik 220 V, 10 A	cope	35		
57	ofert e	Galixhant elektrik 220 V, 10 A (per ujra te ndotur)	cope	20		
58	k.ngj	Transformator 220/12 V 20A	cope	2		
59	k.ngj	Transformator 220/24 V 5A	cope	2		
60	k.ngj	Voltmeter analog 72x72 mm 0-600 V	cope	2		
61	k.ngj	Voltmeter analog 96x96 mm 0-600 V	cope	2		
62	k.ngj	Voltmeter elektronik	cope	2		
63	k.ngj	Ampermeter analog 100/5 A, 72x72 mm	cope	2		
64	k.ngj	Ampermeter analog 250/5 A, 96x96 mm	cope	2		
65	k.ngj	Ampermeter analog 400/5 A, 96x96 mm	cope	2		
66	k.ngj	Ampermeter analog 600/5 A, 96x96 mm	cope	2		
67	k.ngj	Ampermeter analog 1000/5 A, 96x96 mm	cope	2		
68	k.ngj	Ampermeter elektronik	cope	2		
69	k.ngj	Transformator rryme 100/5 A	cope	1		
70	k.ngj	Transformator rryme 400/5 A	cope	1		
71	k.ngj	Transformator rryme 600/5 A	cope	1		
72	k.ngj	Transformator rryme 1000/5 A	cope	1		
73	k.ngj	Mates kohe per oret e punes	cope	1		
74	k.ngj	Siguresa 1P, 6 A	cope	2		
75	k.ngj	Siguresa 1P, 10 A	cope	2		
76	k.ngj	Siguresa 1P, 16 A	cope	2		
77	k.ngj	Siguresa 1P, 40 A	cope	2		
78	k.ngj	Siguresa RTO 63 A	cope	2		
79	k.ngj	Siguresa RTO 100 A	cope	2		
80	k.ngj	Siguresa RTO 160 A	cope	2		
81	k.ngj	Siguresa RTO 200 A	cope	2		
82	k.ngj	Siguresa RTO 250 A	cope	2		
83	k.ngj	Siguresa RTO 400 A	cope	2		
84	k.ngj	Siguresa RTO 500 A	cope	2		
85	k.ngj	Panele metalik 80x60x25 cm, IP65	cope	1		
86	k.ngj	Panele plastik 50x30x20 cm, IP65	cope	1		
		PAJISJE TE VECANTA PER LESHIMIN E ELEKTROPOMPAVE				
1	k.ngj	Panel komandimi me Soft-Starter 22 kW, per elektropompe zhytse 15 kW	cope	1		

2	k.ngj	Panel komandimi me Soft-Starter 30 kW, per elektropompe zhytse 22 kW	cope	1		
3	k.ngj	Panel komandimi me Soft-Starter 45 kW, per elektropompe zhytse 37 kW	cope	1		
4	oferte	Soft-Starter 220 kW, per elektropompe zhytse 200 kW	cope	1		
5	oferte	Inverter 400V, me fuqi 200 kW	cope	1		
6	oferte	Inverter 400V, me fuqi 50 kW	cope	1		
MATERIALE NDRICIMI + AKSESORE INSTALIMI						
1	k.ngj	Ndricules emergjence (kit me bateri)	cope	5		
2	k.ngj	Portollampe e thjeshte E27	cope	20		
3	k.ngj	Llampa LED 15 W, E27	cope	20		
4	k.ngj	Ndricules tavanor LED, 40 W	cope	20		
5	k.ngj	Ndricules mural LED, 40 W (i brendshem)	cope	20		
6	k.ngj	Ndricules mural LED, 50 W (i jashtem)	cope	20		
7	k.ngj	Prozhektor LED, 150 W, (i jashtem)	cope	20		
8	k.ngj	Ndricules rrugor 100 W per montim ne shtylle metalike	cope	5		
9	oferte	Ndricules 100 W me panel diellor (i jashtem)	cope	25		
10	k.ngj	Llampe neon LED, 18 W	cope	2		
11	k.ngj	Llampe neon LED, 36 W	cope	2		
12	k.ngj	Rele muzgu, 220 V, 10 A	cope	10		
13	k.ngj	Celes 1P, 220 V, 10A	cope	2		
14	k.ngj	Celes 1P, 220 V, 10A (jashte murit)	cope	2		
15	k.ngj	Prize bivalente, 220 V, 10 A	cope	2		
16	k.ngj	Prize schuko 220 V, 16 A	cope	2		
17	k.ngj	Prize + spine 3P + N + PE 400 V, 16 A	cope	2		
18	k.ngj	Prize + spine 3P + N + PE 400 V, 32 A	cope	2		
19	k.ngj	Prize schuko 220 V, 16 A (jashte murit)	cope	2		
20	k.ngj	Kuti shperndarese 10 x 10 cm (jashte murit)	cope	2		
21	k.ngj	Kanaline plastike 30x20mm	ml	10		
22	k.ngj	Kanaline plastike 50x20mm	ml	10		
23	k.ngj	Kuti kuadri 8M, jashte murit	cope	2		
KABLO FUQIE + AKSESORE						
1	k.ngj	Percjelles bakri 1.5 mm2	ml	50		
2	k.ngj	Percjelles bakri 2.5 mm2	ml	50		
3	k.ngj	Percjelles bakri 4 mm2	ml	50		
4	k.ngj	Percjelles bakri 6 mm2	ml	50		
5	k.ngj	Percjelles bakri 10 mm2	ml	30		
6	k.ngj	Percjelles bakri 16 mm2	ml	50		
7	k.ngj	Percjelles bakri i zhveshur 35 mm2	ml	50		
8	k.ngj	Kabell 3 x 1.5 mm2, FROR 0.6/1 kV	ml	50		
9	k.ngj	Kabell 3 x 2.5 mm2, FROR 0.6/1 Kv	ml	50		
10	k.ngj	Kabell 3 x 4 mm2, FROR 0.6/1 kV	ml	50		
11	k.ngj	Kabell 4 x 2.5 mm2, FROR 0.6/1 kV	ml	50		
12	k.ngj	Kabell 4 x 4 mm2, FROR 0.6/1 kV	ml	50		

13	k.ngj	Kabell 4 x 6 mm2, FROR 0.6/1 kV	ml	50		
14	k.ngj	Kabell 4 x 10 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	50		
15	k.ngj	Kabell 4 x 16 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	50		
16	k.ngj	Kabell 4 x 25 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	50		
17	k.ngj	Kabell 4 x 35 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	50		
18	k.ngj	Kabell 4 x 50 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	30		
19	k.ngj	Kabell 4 x 70 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	20		
20	k.ngj	Kabell 4 x 95 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	20		
21	k.ngj	Kabell 4 x 120 mm2, FG70R 0.6/1 kV	ml	20		
22	oferte	Kabell ABC 4x16 mm2	ml	100		
23	oferte	Kabell ABC 4x25 mm2	ml	100		
24	k.ngj	Kordo Cu 1 x 50 mm2, 1/0.6 kV	ml	10		
25	k.ngj	Kordo Cu 1 x 70 mm2, 1/0.6 kV	ml	10		
26	k.ngj	Kordo Cu 1 x 120 mm2, 1/0.6 kV	ml	10		
27	k.ngj	Kordo Cu 1 x 240 mm2, 1/0.6 kV	ml	10		
28	k.ngj	Kapikorda Cu 16 mm2	cope	10		
29	k.ngj	Kapikorda Cu 25 mm2	cope	10		
30	k.ngj	Kapikorda Cu 35 mm2	cope	10		
31	k.ngj	Kapikorda Cu 50 mm2	cope	10		
32	k.ngj	Kapikorda Cu 70 mm2	cope	10		
33	k.ngj	Kapikorda Cu 95 mm2	cope	10		
34	k.ngj	Kapikorda Cu 120 mm2	cope	10		
35	k.ngj	Kapikorda Cu 185 mm2	cope	10		
36	k.ngj	Kapikorda Cu 240 mm2	cope	10		
37	k.ngj	Mufte TU (10 - 25) mm2	cope	5		
38	k.ngj	Mufte TU (25 - 35) mm2	cope	5		
39	k.ngj	Mufte TU (35 - 50) mm2	cope	5		
40	k.ngj	Mufte TU (50 - 70) mm2	cope	5		
41	k.ngj	Elektroda tokezimi zingato L=1,5m + aksesore	cope	10		
PAJISJE TM + MATERIALE PER KABINAT ELEKTRIKE						
1	oferte	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 630 kVA	cope	1		
2	oferte	Transformator fuqie 20/0.4 kV, 250 kVA	cope	1		
3	oferte	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 100 kVA	cope	1		
4	oferte	Transformator fuqie 10/0.4 kV, 50 kVA	cope	1		
5	oferte	Cele linje 24 kV, 630 A	cope	1		
6	oferte	Cele transformatori 24 kV, 630 A	cope	1		
7	k.ngj	Sigurese 20 kV, 20A	cope	20		
8	k.ngj	Sigurese 20 kV, 25A	cope	20		
9	k.ngj	Bazament sigurese 20 kV	cope	5		
10	k.ngj	Sigurese 10 kV, 10A	cope	5		
11	k.ngj	Sigurese 10 kV, 15A	cope	5		
12	k.ngj	Sigurese 10 kV, 20A	cope	5		

13	k.ngj	Sigurese 10 kV, 25A	cope	5		
14	k.ngj	Bazament siguresse 10 kV	cope	5		
15	k.ngj	Thike TM 10 kV, 400 A	cope	2		
16	k.ngj	Shkarkues 10 kV	cope	2		
17	k.ngj	Shkarkues 20 kV	cope	2		
18	k.ngj	Doreza Dielektrike	pale	5		
19	k.ngj	Kepuce Dielektrike	pale	5		
20	k.ngj	Tapeta dielektrik 80x40 cm	cope	5		
21	k.ngj	Tabela te sigurimit teknik	cope	5		
22	k.ngj	Indikator TM 10 kV	cope	2		
23	k.ngj	Indikator TM 20 kV	cope	2		
24	k.ngj	Shtange TM 20 kV	cope	2		
25	k.ngj	Koka kablli TM 10 kV	cope	5		
26	k.ngj	Koka kablli TM 20 kV	cope	5		
MATERIALE + VEGLA PUNE + PAJISJE MBROJTESE						
1	k.ngj	Izolant i thjeshte	cope	50		
2	k.ngj	Izolant kunder ujit	cope	30		
3	k.ngj	Valixhe pune per specialist elektrik	cope	2		
4	k.ngj	Set kacavidash 1000V	cope	2		
5	k.ngj	Indikator TU	cope	2		
6	k.ngj	Set pincash 1000V	cope	2		
7	k.ngj	Multimeter dixhital	cope	2		
8	k.ngj	Dare per matjen e rrymave AC/DC, deri ne 2000A	cope	2		
9	k.ngj	Sharre Hekuri	cope	2		
10	k.ngj	Cekic	cope	2		
11	k.ngj	Thike per kabllot	cope	3		
12	k.ngj	Set celsash kriket	set	2		
13	k.ngj	Trapan dore me bateri + nje bateri rezerve + karikues	cope	2		
14	k.ngj	Matrapik 800 W	cope	2		
15	k.ngj	Shkalle Alumini H>4 m	cope	1		
16	k.ngj	Zgjatues me priza 50 m rrote	cope	2		
17	k.ngj	Prese kapikordash hidraulike 16T	cope	1		
18	k.ngj	Bateri 12V, 100Ah (me xhel)	cope	4		
19	k.ngj	Bateri 12V, 140Ah (me xhel)	cope	4		
20	k.ngj	Karikues baterish 12/24 V, 3600 W	cope	1		
21	k.ngj	Tub fleksibel Ø32 mm	ml	100		
22	k.ngj	Tub fleksibel Ø50 mm	ml	100		
		SHUMA	leke			
		T.V.SH	leke	20%		
		SHUMA TOTALE	leke			

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “General Trading S.A” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Nr.Fatures	Vlera e fatures pa TVSH
-------------------	--------------------------------

44/2023, date 12.09.2023	791,666.67
46/2023, date 13.09.2023	928,833.33
48/2023, date 13.09.2023	1,153,750
49/2023, date 14.09.2023	61,475
51/2023, date 16.09.2023	638,499.99
52/2023, date 16.09.2023	544,166.66
53/2023, date 16.09.2023	621,666.67
55/2023, date 13.10.023	357,909.16
58/2023, date 27.10.2023	677,625
59/2023, date 27.10.2023	60,429.17
62/2023, date 13.11.2023	290,958.33

Ndersa operatori ekonomik Nika Trading'' SHPK për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Nr.Fatures	Vlera e fatures pa TVSH
43/2023, date 17.08.2023	291,667
26/2024, date 26.04.2024	833,907
1766/2023, date 16.12.2023	121,731
87/2024, date 27.12.2024	417,373
91/2024, date 31.12.2024	333,392
37/2025, date 21.05.2025	1,498,900
1/2022, date 16.05.2022	999,809
74/2022, date 30.08.2022	124,372
77/2022, date 02.09.2022	124,950
79/2022, date 03.09.2022	124,950
3/2023, date 24.01.2023	417,417
13/2023, date 05.04.2023	999,454
44/2023, date 18.08.2023	1,666,666.67
1239/2023, date 29.08.2023	118,558
63/2023, date 13.12.2023	416,929
1815/2023, date 26.12.2023	98,342
1819/2023, date 27.12.2023	123,623
1821/2023, date 28.12.2023	122,300
8/2024, date 06.02.2024	833,747
373/2024, date 01.03.2024	74,760
31/2024, date 21.05.2024	195,527

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.7. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë

pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “*dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

III.2.9 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, nga krahasimi i faturave tatimore të paraqitura nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK me formularin e sasise dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të objektit të prokurimit, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të furnizimeve të ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomikë, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës dhe specifikave të objekt të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP gjykon, se kemi të bëjmë me një furnizim të materiale elektrike. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon furnizime të mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për furnizim mallrash ligjvënësi në nenin 40 pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter mund të përmbushet me një ose disa kontrata të mëparshme, të ngjashme ose fatura tatimore të shitjes të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës tre vjecare sikundër

parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar dëshmojnë, se kanë kryer furnizime të ngjashme për materiale elektrike pasi të gjitha faturat e paraqitura nga këta operatorë ekonomikë në objektin e tyre e kanë materiale elektrike. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e faturave tatimore nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë/faturë furnizimi, shërbimi por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën/faturat duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në rastin konkret, faturat tatimore të paraqitura nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK janë fatura me objekt materiale elektrike, pra me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK, konstatohet se këta të fundit për të përmbushur kriterin në lidhje me furnizimet e ngjashme kanë paraqitur Fatura Tatimore Shitje ku rezultojnë se kanë kryer furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi me institucione shtetërore dhe private. Nga verifikimi i këtyre faturave tatimore të shitjes rezulton se operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK kanë kryer furnizime gjatë tre viteve të fundit nga data publikimit të kontratës me artikujt objekt prokurimi të cilat në total për operatorin ekonomi “GENERAL TRADING” SHPK përbëjnë vlerën 6,128,979.98 lekë pa TVSH, ndërsa për operatorin ekonomik “NIKA TRADING SA” SHPK përbëjnë vlerën 14,471,283,67 lekë pa TVSH. Komisioni Prokurimit Publik pasi mori në shqyrtim në themel faturat tatimore të shitjes të cilat përmbushin tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brenda afatit 3 vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë zëra të ngjashëm me zërin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar, mori në shqyrtim ato fatura tatimore të shitjes, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, dhe nga përlllogaritja e tyre vëren se, faturat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “GENERAL TRADING” SHPK dhe “NIKA TRADING SA” SHPK, rezultojnë se janë në vlerën 6,128,979.98 lekë pa TVSH për “GENERAL TRADING” SHPK dhe në vlerën 14,471,283,67 lekë pa TVSH për “NIKA TRADING SA” SHPK, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet përvojë me furnizime të ngjashme në vlerën 4,604,228 lekë pa TVSH që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Sa më lart, nga verifikimi i faturave tatimore të shitjes të paraqitura nga operatorët ekonomikë “NIKA TRADING SA” SHPK dhe “GENERAL TRADING” SHPK si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se këta operatorë ekonomikë jo vetëm kanë kryer po dhe kanë tejkaluar masën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në DST sa i përketë furnizimeve të ngjashme me zërin objekt prokurimi të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur, Mallra; Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te Percaktuara”, me Nr.REF-65176-10-15-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Shoqërisë”, me fond limit 11,510,570 (njemdhjetë milion e pesëqind e dhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 27.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publikk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

